

Archival Buildings in Kosovo

REFIKE SÛLÇEVSI

The State Agency of Kosovo Archives, Director of Department for Development Policy, Lagjja e Spitalit p.n.,
10000 Prishtinë, Kosovë,
e-mail: arkkosoves@hotmail.com, refikes@hotmail.com

Archival Buildings in Kosovo

ABSTRACT

To perform normal activity, for which it is established, the archive should have the normal conditions for work. Among the basic requirements are the premises for work, storage and preservation of archival material which in the archival terminology we call them archive buildings. The archival buildings by their characteristics of architectural construction, location and other features should fulfil basic norms and archival standards so successfully can perform basic functions of archive. Basic aim of archival building is to provide suitable accommodation for the establishment, preservation, processing, utilization, etc. of archival material. In Kosovo function the State Archive of Kosovo and six other regional archives. Kosovo State Archives has modern building, inaugurated in 1977, but the other regional archives are mostly located in buildings adapted for the archive. Of these buildings, the regional adopted archive building in Pristina is historical character building, but meets the requirements and standards necessary for the archive.

Edilizia archivistica in Kosovo

SINTESI

Per eseguire la normale attività per la quale è stato fondato l'archivio deve avere normali condizioni di lavoro. Tra i requisiti di base sono la sede per la lavorazione, lo stoccaggio e la conservazione del materiale archivistico, che nella terminologia archivistica chiamiamo edifici adibiti ad archivio. Gli edifici d'archivio, con le loro caratteristiche di costruzione architettonica, posizione e altre caratteristiche devono soddisfare le norme fondamentali e gli standard archivistici in modo da essere in grado di eseguire con successo le funzioni di base di archiviazione. Obiettivo fondamentale della costruzione di un archivio è quello di fornire un alloggio adeguato per la creazione, conservazione, elaborazione, utilizzo, ecc di materiale d'archivio. In Kosovo funzionano l'Archivio di Stato del Kosovo e sei altri archivi regionali. L'Archivio di Stato del Kosovo è un moderno edificio, inaugurato nel 1977, ma gli altri archivi regionali sono per lo più situati in edifici adattati ad archivio. Di questi edifici, quello dell'Archivio Regionale di Pristina è una costruzione di carattere storico, ma soddisfa i requisiti e gli standard necessari per l'archivio.

Arhivske zgradbe na Kosovu

IZVLEČEK

Arhiv mora imeti za normalno izvajanje funkcij, zaradi katerih je bil ustanovljen, normalne pogoje za delovanje. Med osnovne zahteve sodijo primerni delovni prostori, skladišča in ustrezna hramba arhivskega gradiva, kar v arhivski terminologiji imenujemo arhivske zgradbe. Arhivske zgradbe morajo za uspešno izvajanje osnovnih funkcij arhiva izpolnjevati določene kriterije in arhivske standarde v smislu arhitekturne gradnje, lokacije in drugih posebnosti. Glavni cilj arhivskih zgradb je omogočanje primerne prostora za ustanovo, hrambo, obdelavo, uporabo itd. arhivskega gradiva. Na Kosovu deluje državni arhiv ter šest regionalnih. Državni arhiv Kosova deluje v moderni zgradbi, odprti leta 1977, medtem ko ostali arhivi delujejo večinoma v adaptiranih zgradbah. Prostori arhiva v Prishtini v so zgodovinski stavbi, ki kljub temu izpolnjuje pogoje potrebne za arhiv.

Ndërtesat arkivore në Kosovë

ABSTRAKT

Për kryerjen e veprimtarisë së vetë normale, për të cilën edhe është themeluar, arkivi duhet t'i ketë edhe kushtet normale për punë. Ndër kushtet themelore janë lokalet për punë, vendosja dhe ruajtja e lëndës arkivore që në terminologjinë arkivore i quajmë ndërtesa të arkivit. Ndërtesa arkivore është objekt ose grup i objekteve të cilat

me karakteristikat e tyre të ndërtimit arkitektonik, lokacionit dhe veçoritë tjera duhet ti plotsojnë normat dhe standardet themelore arkivore në mënyrë që me sukses të mund ti kryejnë funksionet themelore dhe përcjellëse të arkivit. Çëllimi themelor i ndërtesës së arkivit është që të sigurojë lokal të përshtatshëm për vendosjen, ruajtjen, përpunimin, shfrytëzimin etj. të lëndës arkivore. Në Kosovë funksionon Arkivi Shtetëror i Kosovës, si dhe 6 arkiva tjera rajonale. Arkivi Shtetëror i Kosovës posedon ndërtesën moderne të inaguruar në vitin 1977, ndërtesat e arkivave të tjera rajonale janë kryesisht të vendosura në ndërtesa të adaptuara për arkiv. Prej këtyre objekteve, ndërtesa e Arkivit rajonal të Prishtinës e adaptuar është ndërtesë e karakterit historik, mirëpo i përm-bush kërkesat dhe standardet e nevojshme për arkiv.

Hyrje

Vendi ku ruhet lënda arkivore janë arkivat. Ato janë shtyllat e një shteti demokratik. Arkivat përbëjnë një pjesë thelbësore dhe të pazëvendësueshme të pasurisë kulturore, historike, shkencore etj. Ato ruajnë përjetësinë e kujtesës njerëzore, përkatësisht thesarin kulturor të një populli, treve ose të një vendi. Duke ruajtur thesarin e shkruar nga e kaluara, arkivat kontribuojnë në ruajtjen jo vetëm të thesarit kulturor dhe historik, por edhe të identitetit, vetëdijes dhe vlerave themelore të rrethit të cilit i takojnë.

Hapësira për ruajtje të lëndës arkivore dhe zhvillimin e veprimtarisë së arkivave janë ndërtesat. **Ndërtesat janë** një prej parakushteve themelore për organizimin e shërbimit arkivor dhe mbrojtjes së lëndës arkivore. Përveç lokaleve për punë, me rëndësi të posaçme në arkiva janë lokalet për vendosjen dhe ruajtjen e lëndës arkivore, të cilat në arkivistikë i quajmë depo.

Shërbimi arkivor në Kosovë është një ndër shërbimet më të reja në Ballkan dhe më gjerë. Kjo është reflektuar edhe në sigurimin e objekteve të arkivave. Një kohë të gjatë, por edhe sot në masë të madhe ndihet nevoja për objekte adekuate për arkiva.



Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës - The State Agency of Kosovo Archive

Roli i ndërtesës arkivore

Ndërtesa arkivore është objekt ose grup i objekteve të cilët me karakteristikat e tyre të ndërtimit arkitektonik, lokacionet dhe veçoritë tjera duhet t'i plotësojnë normat dhe standardet themelore (minimale) arkivore në mënyrë që me sukses të mund t'i kryejnë funksionet themelore dhe përcjellëse të arkivit. Qëllimi themelor i ndërtesës së arkivit është që të siguroj lokal gjegjës për vendosjen, ruajtjen, përpunimin, shfrytëzimin etj. të lëndës arkivore.

Krahas resurseve njerëzore dhe suazave programore të cilat e përcaktojnë veprimtarinë e progra-

mit arkivorë, bazën e tyre e përbën lokali dhe pajisjet të cilat janë të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë. Këtu duhet përfshirë edhe resurset financiare, sistemet informative, si dhe resurset informative dhe dokumentare që janë mbështetëse të veprimtarisë dhe të afarizmit. Shumë çështje që janë të ndërlidhura me lokalet dhe pajisjet kanë të bëjnë edhe me mbrojtjen e lëndës (kushtet dhe pajisjet në depo), andaj më së shumti flitet në atë kontekst.

Lokali i arkivit është një prej parakushteve themelore për organizimin e shërbimit arkivor dhe mbrojtjes së lëndës arkivore. Lokali duhet të përcaktohet në atë mënyrë, që të ndikojë në funksionimin më të mirë të shërbimeve përkatëse të arkivit, duke filluar prej pranimi të lëndës arkivore, vendosja në depo, rregullimit, përpunimit, mbrojtjes e deri të shfrytëzimi i saj dhe puna me palë. Pra, qëllimi themelor i objektit të ndërtesës së arkivit është që të siguron lokal gjegjës për vendosjen, ruajtjen, përpunimin, shfrytëzimin etj. të lëndës arkivore.

Qëllimi themelor i ndërtesës së arkivit dhe niveli i veprimtarisë arkivore kushtëzojnë dedikimin struktural të vetë ndërtesës, pa marrë parasysh se a ka të bëjë me ndërtesë të re ose ndërtesë të vjetër të adaptuar. Dedikimin themelor të ndërtesës së arkivit e përcakton edhe degëzimi i përdorimit struktural. Përveç kësaj, për dedikim struktural të ndërtesës së arkivit duhet pasur parasysh edhe këto elemente: territori ku vepron, sasia e lëndës arkivore, e cila krijohet dhe duhet të merret nga ana e arkivit, laboratoriumet për mbrojtjen e lëndës arkivore, numri i punëtorëve të punësuar në arkiv, frekuentimi i shfrytëzuesve të lëndës arkivore dhe mundësitë e perspektivës së ardhshme të arkivit.

Standardet për ndërtesa arkivore

Shërbimi arkivor bashkëkohor përherë synon që në nivel global të sillen standardet për kryerjen e punëve profesionale arkivore dhe administrativo-financiare në ndërtesa të arkivit.

Përkitazi me standardet rreth ndërtimit të ndërtesave arkivore mund të theksohen disa parime në të cilat standardet mund të mbështeten: 1. *Lokacioni* – është një prej kushteve themelore dhe më të rëndësishme për ndërtesat arkivore; 2. *Mjedisi jetësor*; 3. *Kushtet urbanistiko-arkitektonike*; 4. *Rregullativa juridike dhe ligjore*; 5. *Hyrja, qasja në ndërtesa arkivore*; 6. *Mirëmbajtja, sigurimi dhe mbrojtja nga fatkeqësitë elementare*; 7. *Struktura e organizimit të hapësirës*; 8. *Kushtet e ngrohjes akustike ajrore dhe drita në ndërtesën e arkivit*.

Pjesët funksionale të ndërtesave arkivore

Duke u nisur nga kërkesat e disa funksioneve arkivore (vlerësimi, pranimi dhe përpunimi, mbrojtja, shfrytëzimi i lëndës arkivore dhe veprimtaria publike e arkivit), lokali ku zhvillohet veprimtaria arkivore mund të ndahet në katër tërësi funksionale: 1. depot, 2. lokalet për shfrytëzim të lëndës arkivore dhe lokalet publike, 3. Lokalet për përpunimin e lëndës arkivore dhe 4. Lokalet për punët administrative. Në çdo njëërën prej këtyre tërësive funksionale të lokaleve ekzistojnë kërkesa të veçanta në aspektin e organizimit dhe pajisjeve, sigurimit dhe kushteve të cilat duhet të sigurohen. Aty ku është e mundur, duhet synuar që disa tërësi funksionale të jenë të vendosën nivele të llojllojshme të sigurimit dhe regjimit të lëvizjeve dhe qëndrimit të të punësuarve si dhe të vizitorëve.

Gjendja e ndërtesave arkivore në Kosovë

Sistemi arkivor në Kosovë që nga viti 2009 është i centralizuar. Në Kosovë funksionon Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës. Në kuadër të kësaj Agjencie janë: Arkivi Shtetëror i Kosovës, Arkivat rajonale në Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Gjilan dhe Prishtinë. Në mungesë të lokaleve të nevojshme dhe problemeve e mëhershme rreth financimit të arkivave, disa komuna në Kosovë i kanë formuar arkivat e tyre komunale. Këto arkiva posedojnë kryesisht me dokumentacion të ri. Mbi-këqyrjen në aspektin profesional e bënë Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës.

Mungesa e shërbimit arkivor në Kosovë është reflektuar edhe në sigurimin e ndërtesave adekuate për Arkiv. Puna në arkivat e Kosovës ka filluar në vitin 1951, me themelimin e Arkivit të Kosovës, dhe më pastaj të arkivave nëpër rajone.

Në Kosovë objektet e arkivave janë siguruar në dy mënyra: përmes ndërtimit adekuat të ndërtesës së dedikuar për arkiv (ku deri diku janë respektuar standardet e arkivistikës, ndërtimtarisë etj.) ose përmes adaptimit të ndonjë objekti ekzistues.

Me themelimin e arkivave, duke filluar nga Arkivi Shtetëror i Kosovës, ato vendoseshin në disa objekte të vjetra ekzistuese. Madje, nuk u bënte as adaptimi i atyre ndërtesave për arkiv. Por, ashtu siç u vendoseshin arkivat. Me kalimin e kohës kjo gjendje ndryshojë për të mirë.

Në vitin 1977 inaugurohet ndërtesa e Arkivit Shtetëror të Kosovës. Kjo ndërtesë është ndërtuar atëherë në periferi të Prishtinës, në kushte shumë të përshtatshme në aspektin territorial. Është dy katëshe dhe katin përdhës, e dedikuar për arkiv. Depoja e arkivit është 5 katëshe dhe e lidhur me një urë lidhëse. Pjesa e depos është ndërtuar sipas standardeve, nga betoni dhe armatura dhe me dritare në të cilat nuk depërtojnë drejtpërdrejt rrezet e diellit. Mirëpo, pjesa administrative, laboratoriumet, lokalitete për shfrytëzim të lëndës arkivore janë të ndara nga druri, që paraqet rrezik permanent. Fillimisht në këtë ndërtesë punonin e vepronin vetëm zyrtarët e arkivit. Pas tri vite inaugurimi, aty u vendosë edhe Instituti i Historisë së Kosovës dhe në vitet e tetëdhjeta u vendosë edhe depoja e arkivit audiovizuar të Televizionit të Prishtinës. Pas mbarimit të luftës në Kosovë në vitin 1999, në mungesë të lokaleve për punë të institucioneve të tjera, në vitin 2000 u vendos Agjencia Kadastrale e Kosovës, e cila e morri tërë katin e dytë të Arkivit. Kështu, që në Arkiv sot janë të vendosur katër institucione. Kjo ka ndikuar dhe po ndikon në punën e Arkivit Shtetëror të Kosovës.

Arkivi rajonal në Prizren, i formuar në vitin 1968, një kohë të gjatë ishte vendosur përkohësisht në disa ndërtesa të papërshtatshme, madje edhe shtëpi private. Për shkak të ndërtimeve urbanistike ato rrënohesh dhe arkivi kalonte në ndërtesat tjera. Kështu ndodhi deri në vitin 2010, kur u vendos në një aneks të katit të ish ndërtesës Bankës së Kosovës, filiali në Prizren. Ky arkiv tani është në kushte më të mira, por duhet që një pjesë në aneks të saj të adaptohet për depo. Për mungesë të mjeteve financiare kjo punë ka mbetur që të kryhet në të ardhmen.

Arkivi rajonal në Mitrovicë është i vendosur në një aneks të Shtëpisë së Kulturës. Pas vitit 1999 në një pjesë të atij aneksi ishin vendosur trupat ndërkombëtar. Para tri viteve atë e lirojnë. Por, për vendosje të Arkivit edhe në atë pjesë duhen mjete financiare të ndonjë donacioni për adaptim, por deri me tani këtu nuk ka pasur ndonjë sukses. Ajo pjesë ku është i vendosur Arkivi nuk ka kushte minimale për punë.

Arkivi i rajonal i Gjilanit- Shtëpia e vjetër ku ishte vendosur Arkivi në Gjilan, në tërmetin e vitit 2002 është dëmtuar. Arkivi është detyruar të vendoset në një kat të Konviktit të Shkollave të Mesme në Gjilan. Ai lokal ku është vendosur Arkivi është adaptuar përkohësisht dhe nuk i plotëson kushtet adekuate për punë. Nga ana e Komunës së Gjilanit është ndarë parcela për ndërtim të ndërtesës së re. Por, pritet që në të ardhmen të ndahet buxheti për ndërtim.

Arkivi i qytetit të Prishtinës, në vitin 2010 është vendosur në një ndërtesë e ndërtuar në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore. Ajo është

ndërtesë monumentale dhe e mbrojtur nga shteti si trashëgimi kulturore. Kjo ndërtesë me donacion të Këshillit të Evropës është adaptuar në arkiv. Tani ajo ndërtesë është monumentale dhe për një kohë të gjatë i plotëson kushtet optimale për zhvillimin e veprimtarisë arkivore. Është e pajisur me të gjitha aparaturnë për klimatizim, raftë bashkëkohore lëvizëse, të tipit “Ekonomik” dhe pajisjet tjera të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë arkivore.



Arkivi i Qytetit të Prishtinë - Regional Archive of Pristina

Arkivi i Gjakovës është i vendosur në një kat të një ndërtesë – saraji të ndërtuar gjatë periudhës osmane. Tani i është ndarë edhe një kat i asaj ndërtesë, por nuk janë bërë kurrfarë adaptimesh, kështu që Arkivi nuk ka kushte të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë së vet, deri sa të bëhen investime dhe adaptime të lokaleve për arkiv.

Arkivi i Pejës është i vendosur në një ndërtesë të një ish fabrike të qumështit e cila në vitet e shtatëdhjeta të shekullit të kaluar është adaptuar në Arkiv. Kësaj ndërtesë iu është shtuar edhe një kat si mbindërtim. Në të ardhmen duhet angazhuar që për rajonin e Pejës të ndërtohet një arkiv modern.

Konkludim

Nga e tëra ajo që u tha deri më tani mund të konstatojmë se ndërtesa e arkivit, sidomos ato që do të ndërtohen apo të adaptohen ndërtesat ekzistuese apo ndonjë tjetër duhet të jenë funksionale dhe t'i përshtaten kushteve dhe qëllimit themelor të veprimtarisë arkivore, siç janë mbrojtja, rregullimi, përpunimi, shfrytëzimi, ruajtja etj. e lëndës arkivore. Theks të veçantë për ndërtesa arkivore duhet t'iu kushtohet lokaleve për vendosje dhe ruajtje të lëndës arkivore, siç janë depot.

Literatura

Jusuf OSMANI, *Arkivistika – teoria dhe praktika*, Prishtinë 2005.

Jozo IVANCEVIC, *Prirucnik iz arhivistike*, 1, Zagreb 2010.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Dokumenti i numerizuar, Sinteza dhe përvoja Evropiane, Tiranë 2001.

Gazmend BERISHA, *Kujdesi për mbrojtjen e lëndës arkivore*, Prishtinë 2004.


Jusuf OSMANI - Gazmend BERISHA, *Mbrojtja dhe Ruajtja e Lëndës Arkivore*, Prishtinë 2007.

Arhivski standardi i postupci Državnog arhiva Quebeca (prijevod na hrvatski: K. Čvrlak i T. Mušnjak), Zagreb 1994.

Berrin KÜÇÜKCAN, *Üniversitelerde Kütüphane Binaları Kullanım Verimliliğinin Yapı Biyolojisi Açısından İncelenmesi*, İstanbul 2007.

Işıl İlknur SERT, *Yeni Teknolojiler Işığında Bilgi ve Belge Yönetimi*, İstanbul 2012.

Cemil GÖKER, *Arşiv Binaları Teçhizatı – Yazan Michel Duchein*, Çeviren 1974.



Depo moderne për ruajtjen e lëndës arkivore (në letër dhe në film) - Modern Depot(Store) for preserving of archival material(in the paper and film)

SUMMARY

In this paper we will provide a general assessment for the state archives buildings in Kosovo, exactly for Kosovo State Archive and 6 regional archives in Kosovo. Initially, we present what role have the buildings in discharge of archives activity, standards and construction materials for archival building, functional parts of the archival buildings and in the end we speak about the conditions of the state archival buildings in Kosovo, which in general is not at the level of right. Archive services in Kosovo are one of the most innovative services in the Balkans and beyond. The essential aim of archive buildings is to provide suitable accommodation for the establishment, preservation, processing, utilization, etc. of archival material. In the lecture we highlight some principles that can be supported the standards of archives building:

1. Location - is one of the basic conditions and the most important for archive building;
2. Environment;
3. Urban-architectural conditions;
4. Judicial and legal regulations;
5. Entrance, approach in the building;
6. Maintenance, security and protection from natural disasters;
7. Structure and organization of space;
8. Conditions of heat and light in the building of the archive;

The space where the archival activity can be separated into four functional units:

1. Depot (Store);
2. Spaces for the use of archival material and public spaces;
3. Spaces for the processing of archival material;
4. Spaces for administrative affairs.

At the end we also give and analyze some facts about the conditions of archive buildings and about their establishment.

Original scientific article

Submitting date: 01.06.2012

Acceptance date: 30.06.2012